

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap-Kz nr. 129/2012
24 korrik 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel si kryetar i kolegjit, Gjyqtareve të Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe Marije Ademi, dhe Gjyqtarëve të EULEX-it Anne Kerber dhe Martti Harsia si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore Chiara Rojek duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër

S. U., me nofkën [redacted], i lindur më [redacted] në [redacted], emri i babait [redacted] emri i nënës [redacted], shtetas i Kosovës, [redacted] dhe J. V., i lindur më [redacted] në [redacted], Komuna e [redacted], emri i babait [redacted], emri i nënës [redacted], shtetas i Kosovës, me vendbanim në [redacted]


Të akuzuar sipas aktakuzës PP nr. 479/10 të datës 23 maj 2011 e ndryshuar më 3 nëntor 2011 për veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së (kundër S. U.), dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së (kundër Jusuf Vishajt),

Të liruar në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 259/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 30 nëntor 2011 nga vepra penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së sipas nenit 390 Paragrafit 1 pikës 2 të KPPK-së (për S. U. dhe të shpallur fajtorë në shkallën e parë me aktgjykimin e njëjtë për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së dhe të dënuar me një (1) vit burgim (për Jusuf Vishajn).¹

Duke vepruar lidhur me ankesat e paraqitura më 20 shkurt 2012 nga avokati mbrojtës Haxhi Cekaj në emër të pandehurit J. V. më 24 shkurt nga avokatja Nushe Kuka-Mekaj, përfaqësuesja e palës së dëmtuar H. A. më 27 shkurt, nga Prokurori Publik i Qarkut i EULEX-it, të gjitha kundër aktgjykimin P nr. 259/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 30 nëntor 2011, dhe duke pasur parasysh përgjigjen në ankesa të paraqitur më 5 mars nga avokati mbrojtës Gëzim Kollçaku në emër të pandehurit S. U., dhe mendimin dhe propozimin nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK-së) të paraqitur më 24 maj.

Pas mbajtjes së seancës publike më 24 korrik 2012 në prani të pandehurit S. dhe avokatit të tij mbrojtës Gëzim Kollçaku.

¹ Propozim akuzë kundër J. V. në lidhje me veprën penale pjesëmarrje në rrahje është refuzuar sipas nenit 389 Paragrafit 1 pikës 1 të KPPK-së.



Sipas neneve 420 dhe vijuese të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e palës së dëmtuar H A kundër aktgjyqimit P nr. 259/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 30 nëntor 2011, **HEDHET POSHTË** si e palejueshme sipas neneve 420 Paragrafit 1 pikës 1 dhe 422 të KPPK-së.
2. Të gjitha ankesat tjera **REFUZOHEN** si të pabazuara sipas neneve 420 Paragrafit 1 pikës 2 dhe 423 të KPPK-së.
3. Aktgjykimi P nr. 259/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë i datës 30 nëntor 2011, **VËRTETOHET** në tërësi.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 20 nëntor 2010, rreth orës 02.00 të mesnatës në kafenenë Damjana e cila gjendet në fshatin Jabllanicë e Leshanit, Komuna e Pejës, një rrahje në të cilën ishin përfshirë disa persona përfshirë S U J V dhe A H ka rezultuar në lëndimin e S U dhe vdekjen e A H pas të shtënave fatale.

Më 31 maj 2011, Prokurori Publik i Qarkut ka ngritur aktakuzën PP nr. 479/10 të datës 23 maj 2011 duke akuzuar S U për Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, dhe J V për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së. Një propozim akuzë është ngritur si plotësim kundër A U dhe Sh U për veprën penale Pjesëmarrje në rrahje në kundërshtim të nenit 155 Paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Më 27 qershor 2011, aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KAQ nr. 206/11.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur gjatë muajit nëntor 2011. Më 3 nëntor 2011, Prokurori Publik ka tërhequr akuzën e Pjesëmarrjes në rrahje kundër J V

Më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë ka lëshuar aktgjykimin P nr. 259/2011 me të cilin S U është liruar nga akuza për Vrasje sipas nenit 390 Paragrafit 1 pikës 2 të KPPK-së, pasi që kanë ekzistuar rrethanat e mbrojtjes së nevojshme sipas nenit 8 të KPK-së. J V është shpallur fajtor për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së dhe është dënuar me 1 (një) vit burgim. Propozim akuzë kundër J V në lidhje me veprën penale Pjesëmarrje në rrahje është refuzuar sipas nenit 389 Paragrafit 1 pikës 1 të KPPK-së, pasi që Prokurori ka tërhequr akuzat gjatë shqyrtimit gjyqësor.

² I pandehuri i tretë është liruar sipas nenit 390 Paragrafit 1 pikës 3 të KPPK-së, dhe i pandehuri i katërt është shpallur fajtor për Pjesëmarrje në rrahje në kundërshtim të nenit 155 Paragrafit 1 të KPK-së dhe është dënuar me 4 (katër) muaj burgim. Përveç kësaj, Gjykata e Qarkut ka urdhëruar konfiskimin dhe

II. Parashtrësas e palëve

A. Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut

Prokurori i Qarkut ka paraqitur ankesë mbi bazën e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionimin penal sipas neneve 405 dhe 406 të KPPK-së. Ai ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta anulojë aktgjykimin e kontestuar në lidhje me lirimin e S. U. dhe dënimin e shqiptuar ndaj Z. V. dhe ta kthejë lëndën në rigjykim ose ta ndryshoj aktgjykimin.

Prokurori pohon se kolegji i shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vërtetuar faktet në lidhje me akuzat kundër të pandehurit D. U. Kolegji nuk ka marrë në konsideratë në mënyrë të duhur raportin e autopsisë i cili dëshmon se lëndime të shumëfishta të rënda i janë shkaktuar A. H. në kafkë, të shkaktuara nga një mjet i mprehtë, duke dhënë indikacione të fuqishme se i pandehuri e ka sulmuar viktimën me sëpatë para të shtënave. Prandaj, A. H. vepruar në vetëmbrojtje.

Prokurori gjithashtu pohon se gjykata e shkallës së parë ka shpërfillur provat p.sh. deklaratat e dëshmitarit E.G. SH. U. M.P., të cilat kundërshtojnë se sjellja e viktimës ka qenë agresive dhe se sulmi ndaj S. U. ka qenë i pashmangshëm. Më tutje, kolegji ka refuzuar propozimin për të dëgjuar ekspertin mjekësor dhe ekspertin e balistikës për të sqaruar rrethanat në vijim: kohën e shkaktimit dhe pasojat e lëndimeve të gjendjes fizike të viktimës, distancën nga e cila nga ndodhur e shtëna fatale, mungesa e gjurmëve të barutit në duart e A. H. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar nëse S. U. a qenë i dënuar më parë.

Prokurori Publik pretendon se kolegji i Gjykatës së Qarkut nuk ka marrë parasysh dënimet e mëparshme të Z. V. me gjashtë vite dhe gjashtë muaj burgim për Kontrabandim me migrantë në kundërshtim të nenit 138 Paragrafit 1, në lidhje me Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar sipas nenit 137 të KPK-së.

B. Ankesa në emër të pandehurit Z. V.

Mbrojtja pretendon në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale të nenit 403 Paragrafit 1 pikës 3 të KPPK-së dhe kundërshton vendimin mbi sanksionet penale sipas nenit 406 të KPPK-së. Avokati mbrojtës propozon ndryshimin e aktgjyimit të kundërshtuar dhe shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj Z. V. ose anulimin e tij dhe kthimin e lëndës në rigjykim.

Ai pohon se është bërë shkelje e procedurës penale nga gjykata e shkallës së parë sepse Z. V. nuk ka qenë i pranishëm gjatë dy seancave të para të shqyrtimit gjyqësor. Përveç kësaj, theksohet se kolegji i Gjykatës së Qarkut nuk ka marrë parasysh disa rrethana lehtësuese gjatë llogaritjes së dënimit: i pandehuri ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur keqardhje; ai asnjëherë nuk ka qenë në konflikt me ligjin para kësaj procedure; ai është baba i një fëmije dhe i vetmi mbajtës i familjes së tij.

shkatërrimin e pistoletës së tipit TT, kalibr 7.62 mm, me numër serik 26276 dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 100 (njëqind) Euro nga të pandehurit Shqiprim Uka dhe Jusuf Vishaj sipas nenit 99 Paragrafit 2 pikës 6 të KPPK-së

C. Ankesa në emër të palës së dëmtuar H. A.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar pretendon në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së dhe i propozon Gjykatës Supreme që ta anuloj aktgjykimin e kontestuar dhe ta kthej lëndën në rigjykim. Ai pohon se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh disa elemente: viktima është gjetur i vdekur i ulur në tavolinë; disa deklaratave të dëshmitarëve i mungon qartësia; parafina është gjetur në të akuzuarin. Për më tepër, pala e dëmtuar kundërshton refuzimin e kolegjit të Gjykatës së Qarkut për të ftuar ekspertin mjekësor në gjykatë.

D. Përgjigja në ankesën e paraqitur në emër të pandehurit S. U.

Mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë. Ai përmend se S. U. ka vepruar në mbrojtje të nevojshme siç është vërtetuar me deklaratat e të akuzuarit dhe dëshmitarëve si dhe me provat dokumentuese.

E. Mendimi dhe propozimi i ZPSHK-së

Prokurori i shtetit i propozon Gjykatës Supreme që t'i refuzojë të gjitha ankesat dhe të vërtetojë aktgjykimin e kontestuar.³

Në lidhje me të pandehurin S. U., Prokurori i shtetit beson se e tërë gjendja faktike në lidhje me atë çfarë ka ndodhur pasi që A. H. është ngritur nga tavolina e tij nuk është e ditur pasi që provat në dispozicion janë shumë të kufizuara dhe pjesërisht kundërtënëse. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar rrethanat e shkaktimit të lëndimeve të viktimës të cilat janë përmendur në raportin e autopsisë dhe kanë mundur të jenë shkaktuar me sëpatë. Sidoqoftë, nuk është e qartë kush ka qenë duke e mbajtur sëpatën në kohën kritike.

Sipas mendimit të ZPSHK-së, thirrja e ekspertit mjekësor dhe ekspertit të armëve nuk do ofroj prova shtesë që do të shpinin në një rezultat tjetër të procedurës. Fakti se nuk janë gjetur gjurmë të mbetjeve të armës në duart e A. H. as në duart e S. U. nuk provon në mënyrë të besueshme se asnjëri prej tyre nuk ka shtirë me armë.

Më tutje, Prokurori i shtetit pajtohet me refuzimin e kolegjit të Gjykatës së Qarkut për të dëgjuar Prokurorin S. U. i cili i ka zhvilluar intervistat e dëshmitarit M. P.

Sa i përket të pandehurit S. U., Prokurori i shtetit përkujton rrethanat e dy ditëve të para të shqyrtimit gjyqësor kur i pandehuri ka munguar. ZPSHK-ja pohon se mundësia për ta larguar një të akuzuar nga gjykatorja gjatë gjykimin në rast të prishjes së rendit sipas nenit 336 Paragrafit 2 tregon se prania e obligueshme e të pandehurit në gjykimin nuk është pa përjashtime. Qëllimi i nenit 403 Paragrafit 1 pikës 3 të KPPK-së është që të sigurojë një gjykim të drejtë. Në lëndën në fjalë, asnjë provë në lidhje me aktakuzën kundër S. U. nuk është administruar gjatë dy ditëve të para të gjykimin. Mungesa e tij nuk e ka dëmtuar aftësinë e tij për tu mbrojtur ose të drejtën e tij në gjykim të drejtë. Prandaj, Prokurori i shtetit pohon se kjo nuk përbën shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale.

³ Prokurori i shtetit ka pranuar versionin në gjuhën angleze të disa dokumenteve nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe propozon ndryshimin e shkresave të lëndës dhe futjen e këtyre materialeve.

Përfundimisht, Prokurori i shtetit konstaton se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nuk është i tepërt dhe reflekton nivelin e fajësisë së përcaktuar nga Gjykata.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pranueshmëria e ankesave

Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat sipas neneve 26 Paragrafit 1 dhe 398 dhe neneve në vijim të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 3 Paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Aktgjykimi P nr. 259/11 është shpallur më 30 nëntor 2011. Ankesa e avokatit mbrojtës Haxhi Cekaj në emër të pandehurit J V është paraqitur më 20 shkurt 2012. Avokatja Nushe Kuha-Mekaj, përfaqësuese e palës së dëmtuar, ka paraqitur ankesë më 24 shkurt 2012. Ankesa nga Prokurori Publik është paraqitur më 27 shkurt. Përgjigja në ankesa është paraqitur nga avokati mbrojtës Gëzim Kollçaku në emër të S U më 5 mars 2012. Mendimi dhe propozimi i ZPSHK-së është pranuar më 24 maj 2012.

Avokati Haxhi Cekaj e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 10 shkurt. Është vërejtur se i pandehuri J V nuk e ka nënshkruar fletë-dërgesën. Prokurori publik, avokatja Nushe Kuha-Mekaj dhe pala e dëmtuar H A e kanë pranuar aktgjykimin më 10 shkurt. Avokatit mbrojtës Gëzim Kollçaku dhe S U janë dorëzuar ankesat më 29 shkurt dhe 2 mars, përkatësisht.

Është vërejtur se përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka paraqitur ankesë mbi bazën e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, e që nuk është e lejueshme sipas nenit 399 Paragrafit 3 të KPPK-së. Në fakt kjo dispozitë kufizon fushëveprimin e ankesës së palës së dëmtuar vetëm në sanksionet ndëshkuese dhe shpenzimet e procedurës penale. Si rrjedhojë, ankesa e palës së dëmtuar H A është hedhur poshtë si e palejueshme sipas neneve 420 Paragrafit 1 pikës 1 dhe 422 të KPPK-së.


Kolegji i Gjykatës Supreme mendon se ankesat e paraqitura nga avokati mbrojtës Haxhi Cekaj dhe Prokurori publik si dhe përgjigja në ankesa janë të pranueshme sipas neneve 398 Paragrafit 1 dhe 408 të KPPK-së.

B. Meritat e ankesave

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesat janë të pabazuara, prandaj i refuzon ato në tërësi.

1. Ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut lidhur me të pandehurin Syleman Ukaj

Se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar sipas nenit 405 të KPPK-së



Pas vlerësimit të elementeve në shkresat e lëndës, kolegji i Gjykatës Supreme gjen se pretendimi i Prokurorit nuk qëndron, dhe si e tillë pajtohet me parashtrësit e Prokurorit të shtetit dhe mbrojtjes. Gjykata Supreme është e mendimit se kolegji i Gjykatës së Qarkut ka ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm për të përcaktuar të vërtetën dhe ka vërtetuar faktet në mënyrë të saktë. Çfarëdo kërkimi i metutjeshëm nuk do të kishte ndihmuar në përgënjeshttrimin e pohimit se S. U. ka vepruar në vetëmbrojtje, pas një kërcënimi të pa-provokuar ndaj jetes së tij i cili ka arsyetuar qëllimin e viktimës.

Kolegji i poshtëshënuar përkujton rrethanat e ngjarjes: ka ndodhur gjatë një rrahje; ka përfshirë disa persona dhe ka krijuar konfuzion të madh në kafene; disa individë janë lënduar, i pandehuri S. U. është plagosur rëndë dhe A. H. është qëlluar për vdekje; disa nga pjesëmarrësit në rrahje janë në marrëdhënie familjare. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme rrjedha e ngjarjeve të prezantuara nga i pandehuri është vërtetuar deri në një masë të caktuar me anë të provave verbale dhe të dokumentuara. I ndjeri A. H. dhe S. U. janë ballafaquar me njëri tjetrin prej së afërmi dhe viktimë ka shtene dy here në te pandehurin Uka duke e lënduar atë rëndë. Ai pastaj është përgjigjur me zjarr ndaj H.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se, siç është theksuar nga Prokurori i shtetit, provat e prezantuara në lëndë nuk mundësojnë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, në veçanti në lidhje me rrethanat e lëndimit të viktimës, kohën e kryerjes së tyre dhe identitetin e kryerësit.

Në kundërshtim të mendimi të Prokurorit publik, nuk mund të verifikohet se S. U. e ka provokuar viktimën para goditjeve në kafkën e viktimës. Raporti i autopsisë⁴ në të vërtetë përmend se gjurmë të "plagëve të prerjes-gërvishtjes-shqyerjes" dhe "hemorragjisë nën lëkurore ose mavijosje (hematomës)" të shkaktuara nga një veprim mekanik i një mjeti të fortë dhe të mprehtë (prerje) janë gjetur në kafkën e viktimës. Së pari, nuk mund të pritët një saktësi e madhe në rezultatin e një ekspertize tjetër mjekësore pasi që ekspertët e mjekësisë ligjore të cilët e kanë kryer autopsinë nuk kanë mundur të vërtetojnë nëse prerjet në kafkë kanë ndodhur para apo pas vdekjes dhe nëse ato janë shkaktuar nga goditja me sëpatë. Së dyti, nëse një pretendim i tillë mund të vërtetohet, mungojnë provat nëse S. U. ka qenë personi i cili e ka goditur A. H. me sëpatë në kokë. Gjykata Supreme pajtohet se gjykata e shkallës së parë ka mundur të shtjellojë lidhur me këtë rrethanë në arsyetimin e saj me shkrim. Sidoqoftë, arsyetimi mund të gjendet në procesverbalin e gjykimit.⁵ Mbetet se rrethanat e goditjes së A. H. mbeten të pasquruara. Raporti i autopsisë, megjithatë përmend në mënyrë të qartë se te shtënat e shkaktuara në viktimën, dhe jo lëndimet e gjetura në kafkë, kanë qenë shkaktar i vdekjes.⁶

⁴ Raporti i autopsisë nga Departamenti i mjekësisë ligjore, numri i referencës MA 10-308, i lëshuar më 20 nëntor 2010, faqe 3

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Qarkut në Pejë, 30 nëntor 2011, faqe 10

⁶ Raporti i autopsisë nga Departamenti i mjekësisë ligjore, numri i referencës MA 10-308, i lëshuar më 20 nëntor 2010, faqe 6; shkak i vdekjes: plaga depërtuese në regjionin e stomakut e shkaktuar nga një veprim dinamik i plumbit të shtënë nga arma e zjarrit

Sa i përket provokimit të pretenduar të viktimës së ndjerë, është konfirmuar se **S.**
U. gjatë rrahjes ishte duke mbajtur një sëpatë, të cilën e ka përdorur për ta goditur
me bishtin e saj. Ai e ka pranuar këtë fakt në gjykatë. Ai po ashtu e goditi
në shpinë me sëpatë.⁷ Nuk ka mundur të vërtetohet që ai e ka drejtuar
sëpatën kundër

Parashtresa e Prokurorit publik në lidhje me refuzimin për të dëgjuar Prokurorin e
Kosovës **Sinanaj** në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve **E. G.** dhe **M.
P.** është e pa meritë. Gjykata Supreme konsideron se kolegji i Gjykatës së Qarkut me
kujdes ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve dhe besueshmërinë e tyre, duke mos harruar
personalitetin, rolin e tyre në përleshje dhe rrethanat e saj. Për më tepër, dëgjimi i
Prokurorit **Sinanaj** në gjykatë nuk ka zbardhur rrethanat e ngjarjeve. **E. G.** ai ka
konfirmuar deklaratimet e tij të mëhershme sipas të cilave viktimat e ndjerë befasisht
ngritur duke tërhequr revolen e tij dhe duke u afruar tek tavolina e tij. Ai mohoi se i
pandehuri **U.** ia pasur diçka në duart e tij dhe kërcënoi **A. H.** Gjithashtu është
vërejtur se ai ka pirë më shumë se dhjetë (10) shishe me birrë. Gjykata e shkallës së parë
me të drejtë ka refuzuar të thërras Prokurorin e Kosovës në gjykatë për të shtjelluar në
lidhje me deklarinimin e mëhershëm të dëshmitarit. Të njëjtat konkluzione janë arritur për
dëshmitarin **P.** Ai ka konfirmuar se viktimat është ngritur dhe ka nxjerr revolen e tij që
fillimisht ishte drejtuar në tokë.

Gjykata e Qarkut ngjashëm, ka refuzuar të dëgjoj ekspertin e balistikës. Ekspertiza e
balistikës është bërë gjatë hetimeve.⁸ Gjetjet vërtetojnë sekuencën e fakteve të
përshkruara nga gjykata e shkallës së parë. Është konstatuar përdorimi i revoles
HELWAN e kalibrit 9 19 mm me numër serik 1057899 me katër fishekë. Kolegji i poshtë
nënshkruar nuk mund të mohoj që rezultatet pozitive të analizave të mbetjeve të armës
(ang. GSR) do të qartësonin rrethanat e lëndës. Është vërejtur që ekspertët mjeko-ligjore
kanë vazhduar për një ekstrakt të mostrave të gjurmëve të barutit në duart e viktimës dhe
të akuzuarit. Në raport është përmendur se mostrat janë marrë nga **S. U.** në spital
dhe se po ashtu është bërë ekstraktimi i mbetjeve të armës në viktimën. Megjithatë
ekspertiza ka treguar mungesën e mbetjeve të armës në dorën e majtë dhe të djathtë të **A.
H.** dhe **S. U.**¹⁰ Mungesa e mbetjeve të armës lehtë mund të sqarohet me
faktin se ato kanë mundur të largohen kur viktimat dhe i pandehuri janë pastruar në spital
dhe në morg.¹¹ Gjykata e shkallës së parë ka sjellë arsyetimin e bazuar për të refuzuar

⁷ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P nr. 259/2011, 30 nëntor 2011, faqe 14

⁸ Raporti i ekspertizës nga Drejtoria e Laboratorit mjeko-ligjor, nr. referues. 2010-2375, PP nr. 479/2010, i
përfunduar më 01.02.2011; raporti i ekspertizës nga drejtoria e laboratorit mjeko-ligjor. Njësia e ekspertizës
së zjarrit, nr. referues. 2010-2375, PP nr. 479/2010, i përfunduar më 20.12.2010

⁹ Raporti i inspektimit të vendit të ngjarjes nga policia e Kosovës, nr. i dosjes së hetimit: 2010-DA-2560 -
FRP-10-184, i datës 20 nëntor 2010

¹⁰ Shih Qendra Shkencore Mjeko Ligjore e Republikës së Kroacisë, nr. referues i departamenti të gjurmës,
511-01-115/1-2491/11.SK, i datës 16 maj 2011

¹¹ Shih *inter alia* Aktivizimi pas të shtënave dhe ndikimi i saj mbi ruajtjen e mbetjeve fillestare të armëve,
26 Raporti Vjetor Akad. Amer. e Shken. (1974), Dallas, SHBA Kilty JW: Personat të cilët bënë test-
gjuajtjen, bënë ekzaminimin e duarve të tyre për antimon dhe barium në intervale të ndryshme kohore pas
të shtënave. Pas qitjes aktiviteti i gjuajtësit ishte i pakufizuar, përveç larjes së duarve që ishte e ndaluar. Ky
studim ka çuar në konkluzionin se 2 orë pas shkrepjes, ishin larguar sasi të konsiderueshme të antiimon-it
dhe barium-it. Më e rëndësishmja, i njëjti punëtor (46) nuk paraqiti asnjë provë të depozitimit të mbetjeve

propozimin e Prokurorit Publik dhe palës së dëmtuar që Gjykata Supreme përmes kësaj e miraton.

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar parimin siç përcaktohet me Nenin 3 paragrafi 2 të KPPK.¹² Me pak fjalë, faktet ishin vërtetuar në mënyrë adekuate nga kolegji i Gjykatës së Qarkut për të nxjerrë përfundimin se reagimi i S. U. ishte në proporcion me rrezikun e shkaktuar nga sulmi i kundërligjshëm, real dhe i atëqashtëm i të ndjerit A. H. dhe se i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të nevojshme sikurse parashihet nga Nenin 8 i KPK. Rrjedhimisht, lirimi i të pandehurit është arsyetuar sepse ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësin e tij penale në pajtueshmëri me Nenin 390 paragrafi 2 të KPPK.

Se gjykata e shkallës së parë nuk arriti të caktoj dënimin në mënyrë korrekte nga Nenin 406 të KPPK

Është vërejtur se gjykata e shkallës së parë refuzoi propozimin e prokurorisë për të shtyrë shqyrtimin gjyqësor derisa në pritje të dokumentacionit në lidhje me dënimet e mëhershme të S. U. nga autoritetet gjermane. Fragmenti Shkrimores Qendror dhënë nga Zyra Federale për Drejtësi në Bon i datës 17 nëntor 2011 (duke përfshirë informatat për dënimin e S. U. për Vrasje në tentativë) i është dërguar Prokurorit Publik bashkë me ankesën. Ngjarjet në fjalë kanë ndodhur në nëntor 2010 dhe aktakuza PP nr. 479/10 [është ushtruar në maj 2011. S. U. ishte i njohur si i dyshuar që nga dita e incidentit. Gjykata Supreme e Kosovës pranon se kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare mund të marrë ca kohë. Ajo, megjithatë, konstaton se gjykata e shkallës së parë saktë ka vendosur të përfundojë procesin gjyqësor pa pritur për rezultatin e kërkesës së dënimeve të mëparshme.¹³ Gjykata Supreme konsideron se nocioni i gjykimit të drejtë 'brenda kohës së arsyeshme' është i natyrës thelbësore, siç është garantuar nga KPPK-ja, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).¹⁴ Gjykata e shkallës së parë ka proceduar në lëndën në fjalë në një ekuilibër të drejtë të interesave të palëve në procedurë. Së fundi, dënimi i mëparshëm penale i të akuzuarit mund të ketë pasur një ndikim në shqyrtimin e dënimin në Nenin 64 paragrafi 1 të KPK, nëse S. U. do të dënohej, gjë e cila nuk ka qenë çështje.

2. Ankesa e Prokurorit Publik dhe e të pandehurit në lidhje me të pandehurin

Se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të Nenit 403 paragrafi 1 pika 3 të KPPK

Kolegji i Gjykatës Supreme vëren se shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 1 nëntor 2011 në mungesë të J. V. i. Gjykimi ka vazhduar më 2 nëntor pa të pandehurin, i cili po

të armës së zjarrit të mbetura në duart e gjuajtësit pasi që duart u lanë me sapun dhe ujë dhe pastaj u thanë me palloma.

¹² Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P nr. 259/2011, 30 nëntor 2011, faqe 19

¹³ Ibid, faqe 20: shih po ashtu procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 30 nëntor 2011, faqe 10

¹⁴ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të datës 4 nëntor 1950

ashtu mungonte gjatë fjalës përfundimtare më 30 nëntor nëntor.¹⁵ D. V. përfundimisht erdhi në gjykatë më 3 nëntor 2011 dhe gjykimi ishte ri-hapur me pëlqimin e të gjitha palëve. Atë datë, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës u pajtuan të vazhdojnë seancat e gjykimit. Përveç kësaj, Prokurori Publik lexoi aktakuzën dhe procesverbalin i datës 1 dhe 2 nëntor 2011 u konsideruan si të lexuar. Trupi gjykues shfaqti qëllimin e tij të ndaj lëndën kundër D. V. që në të vërtetë nuk u bë. Asnjëri nga dëshmitarët nuk dha deklarime në lidhje me akuzat kundër D. V. gjatë mungesës së tij dhe avokati i tij ishte i pranishëm gjatë këtyre seancave.

Prania e të akuzuarit gjatë gjykimit është e natyrës së domosdoshme sipas rregullave procedurale të Kosovës.¹⁶ KPPK, megjithatë parashetj balancime për këtë parim: shpalljen e aktgjykimit në mungesë të një pale sipas Nenit 392 paragrafi 3, heqjen e të akuzuarit nga salla e gjykatës, në rast të pengimit sipas Nenit 336 paragrafi 2. Procedura në mungesë njihet sipas ligjit të vjetër.¹⁷ Është me rëndësi të përmendet se gjykimi i mbajtur në mungesë të të akuzuarit me garancinë procedurale të rreptë është i mundur në disa sisteme ligjore evropiane.¹⁸

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) konsideron se e drejta për një gjykim të drejtë të përcaktuar në Nenin 6 paragrafët 1 dhe 3 c), d) dhe e) të GjEDNj-së pa dyshim përmban të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë efektive në seancë dëgjimore.¹⁹ Gjykimi *in absentia* duhet të siguroj garanci për një gjykim të drejtë sipas GjEDNj që duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurës.²⁰ Gjykata Evropiane për

¹⁵ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P nr. 259/2011, 30 nëntor 2011, faqe 5; shih po ashtu procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, 3 nëntor 2012, faqet 2-3

¹⁶ Shih *inter alia* Kapitulli XXX (Masat për të siguruar praninë e të pandehurit, për të parandaluar përsëritjen dhe për të siguruar mbajtje të suksesshëm të procedurës penale), neni 321 paragrafi 1, neni 330 paragrafi 1, neni 403 paragrafi 1 pika 3 të KPPK

¹⁷ Neni 300 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë: (1) [...] (2) Një i akuzuar mund të gjykohej në mungesë vetëm nëse ai është në arrati ose është përndryshe i paarrtshëm për agjencitë qeveritare, dhe nëse ka arsye veçanërisht të rëndësishme për ta gjykuar atë edhe pse ai nuk është i pranishëm. (3) Vendimi për të gjykuar të akuzuarin në mungesë do të bëhet nga kolegji sipas propozimit të prokurorit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

¹⁸ Shih Kodin e Belgjikës të udhëzimit penal, Neni 149 dhe më tej; E drejta precedentale e Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Lordëve 20 shkurt 2002, R. k Jones (Anthony) [2003] 1 AC 1, Kodi Francez i Procedurës Penale, Kapitulli VIII procedura e mosparaqitjes në lëndët e krimit, Neni 379-2, *inter alia* Vendimi strukturor i Këshillit të Bashkimit Evropian 11309/08 i datës 2 korrik 2008 për zbatimin e vendimit të dhënë në mungesë dhe që ndryshon Vendimin strukturor 2002/584/JHA për urdhër arrestin evropian [...] (<http://register.consilium.europa.eu/pdf/en/08/st11/st11309.en08.pdf>)

¹⁹ Shih KEDNj, Colozza v. Itali, Kërkesa nr. 9024/80, Aktgjykimi i trupit gjykues, 12 shkurt 1985, para 27: "27. Edhe pse kjo nuk është përmendur shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6 (neni 6-1), objektivi dhe qëllimi i këtij neni i marrë si tërësi tregon që një person "i akuzuar për një vepër penale" ka të drejtën të marrë pjesë në seancë dëgjimore. Për më tepër, nën-paragrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 (nenet 6-3-c, nenet 6-3-d, nenet 6-3-d) "çdo personi të akuzuar për një vepër penale" i garantojnë "të drejtën për të mbrojtur veten", "marrjen ose të kenë marrë dëshmitarë në pyetje "dhe" të kenë ndihmën falas të një përkatësi në qoftë se ai nuk mund ta kuptoj ose flas gjuhën e përdorur në gjykatë", dhe është e vështirë të shihet se si ai mund të ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm."; shih gjithashtu GjEDNj, Poitrimol v France, Kërkesa nr. 14032/88, Aktgjykimi i Trupit Gjykues, 23 nëntor 1993, para. 31

²⁰ Shih gjithashtu GjEDNj, Poitrimol v France, Kërkesa nr. 14032/88, Aktgjykimi i Trupit Gjykues, 23 nëntor 1993, para. 34: "...Një person i akuzuar për një vepër penale nuk e humb përfitimin e kësaj të drejte vetëm për shkak se nuk ishte e pranishëm në gjykim (shih Campbell dhe Fell v. aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar i datës 28 qershor 1984, Seria A nr. 80, f. 45, paragrafi. 99, dhe, *mutatis mutandis*, aktgjykimi

të vënë disa standarde minimale procedurale për t'u zbatuar: autoritetet kombëtare duhet të tregojnë kujdesin e duhur në përpjekjen për të gjetur të akuzuarit dhe të informojnë personin për akuzat dhe detajet e lëndës. Të akuzuarit duhet të kenë të drejtë për një përcaktim të ri të meritave të lëndës, pas gjykimit *in absentia*.²¹ Sipas këndvështrimit të GjEDNj-së, i akuzuari mund të heq dorë nga e drejta e tij të jetë i pranishëm në seancën dëgjimore. Heqja e tillë duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe e rrethuar nga masat mbrojtëse procedurale.

Përputhshmëria e procedurës së tillë me garancitë e një gjykimi të drejtë varet nga rrethanat e lëndës dhe shqyrtohet në bazat lëndë pas lëndë.

Gjykata Supreme është e mendimit se të drejtat e mbrojtjes ishin respektuar në lëndën e *J. V.* Gjykata e Qarkut ka dhënë ftesë për të pandehurin. Ky i fundit ishte duke u përfaqësuar gjatë gjithë kohës nga avokati i tij mbrojtjes. Akuzat në lidhje me atë nuk u diskutuan dhe asnjë provë nuk u paraqit në mungesë të tij. Më në fund, i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtjes shprehimisht ranë dakord që të mos rifillojë gjykimi nga fillimi. Vihet re gjithashtu, se *J. V.* dhe avokati i tij morën pjesë në mënyrë aktive në seancat pasuese të gjykimit. I pandehuri nuk ishte i pranishëm në gjykatë në ditën e shpalljes së aktgjykimit, më 30 nëntor, përkundër faktit se ai ishte ftuar me rregull nga kryetari i kolegjit.²² Atë ditë, avokati i tij përmendi se ai nuk ka mundur ta kontaktoj klientin e tij. Avokati mbrojtës paraqiti fjalën përfundimtare shumë koncize pa ngritur ndonjë pretendim në këtë drejtim.²³ Kjo nuk mund të konsiderohet që *J. V.* ka hequr dorë nga e drejta e tij të jetë i pranishëm në gjykatë në mënyrë të qartë dhe të vendosur. Megjithatë, Kodi autorizon që një aktgjykim të shpallet në mungesë të të akuzuarit sipas Nenit 392, i cili ka ndodhur në lëndën në fjalë.²⁴ Sikurse u theksua nga gjykata e shkallës së parë, i pandehuri pranoi fajësinë për akuzën.

Në fazën ankimore, Shkrimorja e Gjykatës Supreme ka dërguar me rregulle njoftimin për *J. V.* për të siguruar praninë e tij në gjykatë.²⁵ Shkrimorja u përpoq gjithashtu të kontaktojë me të, partnerin e tij dhe avokatin mbrojtës të tij me telefon, për të marrë informacione shtesë për vendndodhjen e tij, por pa sukses. Për më tepër, *J. V.* ka

Goddi i cituar më parë, Seria A nr. 76, f. 12, paragrafi 30., dhe aktgjykimi F.C.B. i cituar më parë, Seria A nr. 208-B, p 21., paragrafi 33) [...]" : *inter alia* Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Mbenge v Republika Demokratike e Kongos, Komunikata nr. 16/1977, 25 mars 1983, paragrafi 14.1:".. Në të vërtetë, procedurat në mungesë janë në disa rrethana (për shembull, kur personi i akuzuar, edhe pse i njoftuar për procedurat në mënyrë të mjaftueshme që më parë, heq dorë për të ushtruar të drejtën e tij të jetë i pranishëm) të lejueshme në interes të administrimit të duhur të drejtësisë."

²¹ Shih GjEDNj, të Krombach v Francë (2001) Kërkesa nr. 29731/96, aktgjykimi 13/05/2001, para. 87. "Sipas këndvështrimit të gjykatës, procedura për një rigjykim pas heqjes së mospërfilljes ndikon vetëm në ushtrimin efektiv të të drejtave të mbrojtjes nëse i akuzuari është arrestuar, sepse në raste të tilla autoritetet kanë një detyrim pozitiv për ti ofruar të akuzuarit mundësinë për të pasur një seancë dëgjimore tjetër të plotë të lëndës në praninë e tij apo të saj [...]"

²² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 15 nëntor 2011, faqe 36

²³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 30 nëntor 2011, faqet 17-18

²⁴ Neni 392 paragrafi 3 të KPPK: Shpallja e aktgjykimit bëhet edhe kur pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi nuk janë të pranishëm. Trupi gjykues mund të urdhërojë që të akuzuarit i cili nuk është i pranishëm t'ia komunikojë gojarisht aktgjykimin kryetari i trupit gjykues ose t'i dërgohet me shkrim aktgjykimi.

²⁵ Shih zarfin që mban njoftimin për të pandehurin, të datës 19 korrik 2012. Është shkruar se i pandehuri ishte jashtë vendit dhe familja nuk mund të pranojnë dokumentin në emër të tij.

paraqitur një ankesë dhe për këtë arsye duhet të ishte në dispozicion të gjykatës që të mundësojë paraqitjen e tij në procedurën e shkallës së dytë. Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se janë bërë të gjitha përpjekjet nga autoritetet që i pandehuri të jetë i pranishëm në gjykatë gjatë procedurës së parë dhe të dytë. Një shtyrje pa afat e procedurës për shkak të pamundësisë për të kontaktuar të pandehurin mund të ndikojë në të drejtat e bashkë- të-pandehurve dhe pengojë përfundimin e lëndës në një kohe të arsyeshme. Rrjedhimisht, sipas mendimit të këtij kolegji, procedura në mungesë është bërë në interes të administrimit të drejtësisë, duke respektuar garancitë minimale të një gjykimi të drejtë për të cilin i pandehuri ka të drejtë. Prandaj arsyja e ankesës është refuzuar si e pabazuar.

Se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje nga Neni 406 të KPPK në caktimin e dënimit të të pandehurit

I pandehuri është dënuar me një (1) vit burgim. Gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh faktet që *Z. V.* ka sjellë armën e tij të mbushur në një restorant dhe se shumicën e kohës e kishte armën e tij me vete si një rrethanë rënduese, dhe se ai ka pranuar mbajtjen e armës si rrethanë lehtësuese.²⁶ Gjykata e Qarkut konsideron se "në Kosovë është e rëndësishme të jepen sinjale të forta se mbajtja në pronësi e paautorizuar e armëve do të ndëshkohet rëndë". Siç u përmend në ankesën e Prokurorit, nuk është marrë parasysh dënimi i mëhershëm i të pandehurit me gjashtë vjet e gjashtë muaj burgim për veprën penale të Kontrabandë me migrantë në lidhje me Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar.

Gjykata Supreme vetëm mund të pajtohet me këto gjetje të shkallës së parë. Kontradiktat mund të lindin për të përfshirë dënimin e mëparshëm penale të një të akuzuari si një element të "sjelljes së kaluar të kryerësit", rrethanë për të marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit, në bazë të Nenit 64 të KPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është i mendimit se dënimi i mëparshëm penal i një të akuzuari është një faktor që duhet të merret parasysh gjatë llogaritjes së dënimit. Kjo pikëpamje përputhet me qëllimet e dënimit të përmendura në Nenin 34 të KPK-së për të parandaluar përsëritjen e një veprë penale dhe për të penguar personat e tjerë nga kryerja e veprave penale. Gjithashtu, Neni 354 i KPPK i jep të drejtën trupit gjykues në mënyrë të qartë të marrë në konsideratë informacionin në lidhje me dënimin e mëhershëm të të pandehurit pasi që të përfundojë paraqitja e provave.

Megjithatë, mosveprimi i tillë nuk ndikon në caktimin e dënimit, sikurse pretendon Prokurori Publik. Një vlerësim i të gjitha rrethanave të lëndës, duke përfshirë edhe karakteristikat personale të *Z. V.* është bërë në nivelin e shkallës së parë për të arritur një vendim mbi sanksionin, në përputhje me Nenin 34 dhe zbatimin e KPK. Për më tepër një (1) vit burgim, është një dënim i përshtatshëm për kryerjen e veprës penale të tillë.

Nuk është e nevojshme për Gjykatën Supreme të përsërisë vërtetimin e saj të parandalimit jetike të posedimit dhe / apo përdorimit të paautorizuar të armëve në Kosovë.

²⁶ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P nr. 259/2011, 30 nëntor 2011, faqe 21

Rrjedhimisht, u vendos si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Horst Proetel

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Marije Ademi

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e EULEX-it Anne Kerber

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Martti Harsia

Procesmbajtëse


Zyrtare Ligjore Chiara Rojek



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz nr. 129/2012

24 korrik 2012

Prishtinë



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TÄČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Drejtori i Informacionit
Ovlašćeni činik